



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Korniza Afatmesme (Buxhetore) e Shpenzimeve

2023 - 2025

Qershor 2023

Përbajtje

HYRJE	3
Korniza e përgjithshme	3
Deklarata e qeverisë komunale për kornizën afatmesme të shpenzimeve 2023 - 2025.....	5
Vizioni dhe Misioni.....	5
Orientimet Strategjike	6
KORNIZA FISKALE	7
PERSPEKTIVA E POLITIKAVE FISKALE	8
BUXHETI KOMUNAL PËR VITIN 2023 - 2025.....	8
Burimet e financimit komunal për vitin 2023 - 2025.....	9
Granti i përgjithshëm	10
Granti specifik për Arsim parauniversitar 2023.....	11
Granti specifik për Shëndetësi primare	12
Financimi për Teatro	12
Parashikimi i të hyrave vetanake komunale 2023 - 2025	12
Parashikimi i shpenzimeve buxhetore për periudhën 2023 - 2025.....	15
Zyra e Kryetarit.....	20
Zyra e Kuvendit Komunal	21
Drejtoria e Administratës dhe Personelit	21
Zyra e Prokurimit	22
Drejtoria e Inspeksionit.....	23
Drejtoria për Buxhet dhe Financa.....	24
Drejtoria e Shërbimeve Publike	25
Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim + Zjarrfikëset.....	26
Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim	27
Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim rural	28
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	29
Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi	30
Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	31
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.....	32
Shërbimet Sociale	32
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	33
Drejtoria për Arsim dhe Shkencë.....	34
PROGRAMI KOMUNAL I INVESTIMEVE PUBLIKE (PIP)	35
Vlerësimi i Kapaciteteve Investuese	35

HYRJE

Korniza e përgjithshme

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2023 - 2025 si dokument i rëndësishëm dhe më kryesor paraqet koherencën, koordinimin dhe ndërlidhjen funksionale në mes të prioriteteve të përcaktuara me dokumentet strategjike komunale për zhvillim në njëren anë si dhe përfshirjen e tyre konkrete e specifike në projeksionet buxhetore për periudhën afatmesme. Duke u bazuar në këto premissa themelore që përfshijnë aspektet e menaxhimit të financave publike, ato fiskale, ekonomike e shoqërore është konceptuar edhe Deklarata e Prioritetave të Qeverisë komunale konform Strategjisë komunale për zhvillim.

Prioritetet e Qeverisë Komunale të Gjakovës si pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve në nivel të Republikës së Kosovës: 2023 - 2025, janë të orientuara drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, infrastrukturës komunale, sektorit të arsimit, kulturës, rinasë dhe sporteve, sektorit të shëndetësisë primare, atë të bujqësisë, mjedisit etj. Prioritetet afatmesme 2023 - 2025, bazohen në Programin e Punës së Qeverisë Komunale dhe prioritetet e saj dhe Strategjinë e Zhvillimit Socio - Ekonomik Lokal për këtë periudhë.

Strategja paraqet një dokument të zhvillimit afatmesëm të planeve të Komunës, zhvillimin e ekonomisë lokale, ku si për qëllim ka përcaktimin e synimeve strategjike të zhvillimit ekonomik lokal dhe krahas kësaj ka planifikimin dhe implementimin e investimeve nga donatorët e jashtëm dhe të brendshëm.

Strategja për zhvillimin ekonomik lokal në komunën e Gjakovës është një dokument që thekson resurset dhe pasuritë e Komunës nga e cila dalin edhe projektet konkrete për realizim. Përgatitja e Strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal ka për qëllim që të shërbej si instrument për një planifikim të proceseve të zhvillimit lokal me gjithë përfshirje, për planifikimin e buxhetit komunal, për mobilizimin e mjeteve financiare, si dhe koordinimin e ndihmave në të dy nivelet, atë lokal dhe qendror. Gjithashtu, kjo do t'i mundësojë administratës komunale për formulimin e një Strategjie afatmesme dhe afatgjate lidhur me zhvillimin ekonomik lokal në territorin e Komunës në planin e ardhshëm 3 vjeçar.

Me Qarkoren e parë buxhetore nr.2023/01, të datës 13.05.2022 të lëshuar nga ana e MF, janë caktuar limitet e para buxhetore për Komuna për periudhën 3 vjeçare: 2023 - 2025 në mesin e të cilave edhe për Komunën e Gjakovës.

Në procesin e realizimit të prioriteteve të Qeverisë komunale rëndësi e veçantë i kushtohet qëndrueshmërisë buxhetore dhe projeksjoneve makro-fiskale për periudhën afatmesme. Në këtë drejtim do të punohet që të vazhdohet me ritmin e ngritjes së vazhdueshme të investimeve kapitale, pastaj të ruhet stabiliteti buxhetor, ngarkesë te ultë te biznesit me tatime si dhe rritja e nivelit të grumbullimit të hyrave vetanake.

Komuna e Gjakovës si mision të vetin ka zhvillimin më të shpejtuar ekonomik të saj sipas prioriteteve të Strategjisë Komunale për Zhvillim Ekonomik të Komunës, duke siguruar ambient të sigurt dhe tërheqës për investitorët. Do të inkurajojë, mbështesë, bashkërendojë dhe koordinojë me efikasitet politika, aktivitete e burime që i kontribuojnë prosperitetit e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm të Komunës, fuqizimit të biznesit dhe sipërmarrjes, për një mirëqenie më të lartë njerëzore. Misioni i Qeverisë komunale për periudhën afatmesme buxhetore, është pëershpejtimi i ritmeve të zhvillimit ekonomik, shtimin e mundësive për shkollim, avancim të llojit dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore, kulturën, rininë dhe sportin, lëmin e bujqësisë si dhe zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit dhe infrastrukturës

komunale si çështje më kryesore që mund të ndikojnë për përmirësimin e shpejtë të gjendjes ekonomike e shoqërore të banorëve të Komunës.

Ky dokument është baza për përcaktimin e sektorëve me prioritet të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2023 - 2025. Ky plan i integruar nuk zëvendëson plane tjera por sigurohet që të gjithë plan programet dhe projektet tona të jenë të kanalizuara dhe të paraqesin koherencën dhe strategjinë e zhvillimit të gjithmbarshëm ekonomik të Komunës sonë në tre vitet e ardhshme. Të gjitha prioritetet e përfshira në këtë Plan të integruar komunal do të financohen duke ruajtur stabilitetin dhe qëndrueshmërinë makro-fiskale. Duke synuar rritjen e vazhdueshme të efektivitetit dhe efikasitetit si dhe përgjegjshmërinë dhe llogaridhëni. Qeveria komunale ka përcaktuar prioritetet për financim. Këto prioritete më tutje do të zhvillohen në objektivat specifike dhe të matshme brenda sektorëve përmes procesit të KASH-it. Objektivat e përcaktuara në KASH do të zhvillohen në aktivitete dhe projekte konkrete përmes procesit të rregullt buxhetor. Duke u bazuar në Planin Zhvillimor Komunal si dhe Qëllimet e Zhvillimit të Mileniumit/Millennium Development Goals, Kornizën Afat Mesme të Shpenzimeve, si dhe Planet individuale Operacional të Departamenteve përkatëse, Komuna e Gjakovës arrin që të krijojë një kornizë e cila do të shpejtojë zhvillimin ekonomik duke siguruar një ambient të sigurtë dhe atraktiv për investitorët. Ato do të balancojnë qëllimet ekonomike, ambientale dhe sociale dhe kështu do të përmirësojnë cilësinë e jetës për të gjithë ne.

Deklarata e qeverisë komunale për kornizën afatmesme të shpenzimeve 2023 - 2025

Duke pasur të vendosur një bazë të mirë nga e cila niset zhvillimi i qëndrueshëm socio-ekonomik i Komunës tonë, priorititet tona për tre vitet e ardhshme janë të fokusuara në katër shtyllat e mëposhtme:

- ❖ Rritja dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik;
- ❖ Qeverisja e mirë dhe fuqizim i sundimit të ligjit;
- ❖ Zhvillimi i resurseve njerëzore;
- ❖ Rritja e standardit jetësor dhe e mirëqenies sociale për banorët e Komunës së Gjakovës.




Figure 1. Pozicioni gjeografik i Gjakovës – dhe transformimi i qytetit ndër vite.

Vizioni dhe Misioni

Vizioni:

GJAKOVA – qytet i vlerave dhe standardeve të mirëfillta, me një ekonomi të zhvilluar dhe konkuruese, një qytet i sigurt që promovon shëndetin, arsimin cilësor gjithëpërfshirës, bujqësinë, kulturën, sportin dhe turizmin dhe krijon një ambient të qëndrueshëm mjedor për banorët e saj dhe jo vetëm.

Misioni:

Misioni i strategjisë se Komunës së Gjakovës është rritja e mirëqenies dhe përmirësimi i kushteve të jetesës së qytetarëve përmes zhvillimit të NVM-ve, rritjes së investimeve kapitale nga buxheti komunal në lëmi të infrastrukturës, turizmit, bujqësisë, sigurimit të cilësisë në arsim si dhe të shërbimeve shëndetësore dhe administrative.

Orientimet Strategjike

Promovimi dhe tërheqja e investimeve lokale dhe të huaja, fondeve të shtetit dhe agjensive të tjera në zhvillimin e sektorit te Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) dhe turizëm si kusht i domosdoshëm në rritjen e punësimit, mundësi e krijimit të vendeve të reja të punës;

Zbutja e varfërisë përmes zhvillimit të bujqësisë;

Ofrimin e mundësive të barabarta në qasjen në infrastrukturë, shkollim cilësor, jetesë të shëndoshë dhe të pastër dhe jetë kulturore dhe sportive të pasur për të gjithë qytetarët e Komunës së Gjakovës.

Objektivat e përgjithshme

1. Të zhvillohet dhe të avancohet sektori NVM-ve dhe turizmit në Gjakovë;
2. Të zhvillohen dhe zgjerohen aktivitetet e sektorit të bujqësisë dhe Agro Industrisë në Gjakovë;
3. Avancimi i sistemit arsimor në të gjitha nivelet e shkollimit;
4. Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës si një kusht për zhvillim lokal, hartimi i hartës zonale, krijimi i një ambienti të qëndrueshëm mjedisor dhe ngritja e nivelit të sigurisë së përgjithshme;
5. Promovimi i shëndetit dhe mirëqenies sociale;
6. Përmirësimi dhe avancimi i shërbimeve administrative për qytetarët dhe menaxhimi i pasurisë komunale;
7. Ruajtja dhe kultivimi i traditës kulturore dhe asaj sportive në funksion të promovimit dhe zhvillimit të turizmit të Gjakovës.

Të gjitha prioritetet e lartpërmendura do të financohen duke ruajtur stabilitetin dhe qëndrueshmërinë makro-fiskale.

Hartimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale konform KASH-it të lëshuar në nivel të Republikës së Kosovës – MF-ve, gjatë muajit Maj 2022 .

Korniza afatmesme buxhetore (KASH-i) komunal paraqet një mjet të procesit për zhvillimit të buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritete e Komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme 3 vjeçare. Me KASH – Komunale do të paraqiten shpjegimet e politikave – prioriteteve të tanishme dhe afatmesme të Gjakovës si dhe projekzionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përbush projektet me prioritet që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2023 - 2025.

KORNIZA FISKALE

Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore) mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën më poshtë. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumenteve të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2023 - 2025 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Me lëshimin e Qarkoreve buxhetore pasuese nga MF-ve, për këtë periudhë mund të shfaqen edhe ndryshime të limiteve buxhetore, si dhe përcaktimin e shpenzimeve buxhetore sipas kategorive ekonomike te shpenzimeve (Paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe investime kapitale).

Në këtë kornizë definohet qartë financimi komunal nga grantet qeveritare për vitin 2023 dhe vlerësimet për vitin 2024 dhe 2025 përfshirë të hyrat vetanake komunale, si pjesë integrale e KASH-it : 2023 - 2025.

Nga aspekti i kornizës së re ligjore, sistemi i financimit komunal ka pësuar reforma progresive përkatësisht ndryshime të mëdha në vijën horizontale dhe vertikale të financimit. Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2023, si dhe pjesëmarria e buxhetit komunal në Buxhetin e Republikës së Kosovës, janë strukturoar në linjë me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL).

Përcaktimi i shumave aggregate të granteve qeveritare dhe alokimi i tyre në komunat individuale në periudhën afatmesme të bazuar nga propozim-grantet specifike nga ministritë e linjës MASHT, MSH, MAPL dhe MPMS, Qeveria e Republikës se Kosovës ka aprovuar KASH-in për periudhën 2023 - 2025.

- ❖ Respektimi dhe zbatimi i parimeve të përgjithshme të përcaktuara në LFPL
- ❖ Formulat shtetërore për arsimin para universitar dhe shëndetësinë primare, për alokimin e granteve specifike në arsim dhe shëndetësi
- ❖ Korniza makro-fiskale si bazë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, në kuadër të prioriteteve qeveritare.

Komunat, nga viti në vit kanë pasur një shkallë të rritur të decentralizmit fiskal dhe transparencës.

Sistemi aktual i financave komunale përbën decentralizimin fiskal të avancuar, komunat kanë kompetencë të konsiderueshme për shpenzimet, kompetencë për ofrim të shërbimeve publike, autorizime për mbledhjen e të hyrave, dhe autoritet të gjerë në menaxhimin e financave publike.

Përkushtimi i përgjithshëm për të përmirësuar elementet kyçë të procesit të zhvillimit të buxhetit, ka kërkuar edhe disa ndryshime në formatin e prezantimit të buxhetit komunal. Prandaj, jemi mbështetur në aspektet kryesore të mëposhtme të procesit buxhetor:

- ❖ Shfrytëzimi i buxhetimit në nivel të programit dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të evidencës kontabël;
- ❖ Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe

- ❖ Zbatimi i konceptit mbi planifikimin shumëvjeçar të buxhetit/kapitaleve dhe prezantimi i të gjithë zërave të buxhetit për vitin paraprak, vitin e tanishëm buxhetor dhe për dy vitet pasuese.

Futja në përdorim e buxhetimit kapital shumëvjeçar, përfshirë këtu integrimin e informatave për rezultatet e planifikuara në sistemin e PIP-it. Gjatë këtij viti komunat do të hartojnë për secilin program strategjinë me synimet dhe objektivat, përfundimet dhe rezultatet që synohen të arrihen përmes procesit buxhetor.

PERSPEKTIVA E POLITIKAVE FISKALE

Sipas KASH-it të Republikës së Kosovës dhe Qarkores së parë buxhetore nr.2023/01 për Komuna të dt. 13.05.2022 dhe në bazë të shënimave statistikore të regjistrimit të fundit të popullsisë së Kosovës të vitit 2011, rrjedhë se Komuna e Gjakovës ka 94.556 banorë, dhe nga Komisioni i Granteve – MF për vitin 2023 Komunës sonë iu është ndarë buxhet fillestar në shumë prej 31,558,423.00 €, nga te cilat Grant Qeveritar 27,354,636.00 € (86.67%), te hyra vetanake 4,203,787.00 (13.33%) i cili buxhet përbën shumën prej 31,558,423 €, apo për – 3,741,492.00 € në total i lartë se për vitin aktual 2022.

Tabela nr. 1. Krahasimi i Buxhetit 2022/2023

Nr.	Përshkrimi	Vlera
	Buxheti komunal 2022 (aktual)	27,816,931.00
	Buxheti i planifikuar 2023	31,558,423.00
	Ndryshimi	+ 3,741,492.00

Burimi: Qarkorja Buxhetore 2023/01, MF 2022

BUXHETI KOMUNAL PËR VITIN 2023 - 2025

Bazuar në tabelat e buxhetit komunal nga vitet e kaluara dhe me qëllim të vazhdimit të reformave të procesit buxhetor, buxheti komunal për vitin 2023 do të planifikohet dhe pasqyrohet sipas strukturës bazë të programeve dhe nën-programeve buxhetore. Për të përmirësuar gjithë-përfshirjen, transparencën dhe kredibilititin e formulimit të buxhetit komunal, synohet që hartimi i buxhetit të ndërtohet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitetë (LMFPP).

Prioritet për financim kanë projektet që janë të vazhdueshme që kane filluar në vitet e mëparshme dhe atyre që janë në harmoni me prioritetet e Komunës.

Burimet e financimit komunal për vitin 2023 - 2025

Financimi komunal përfshinë: grantet specifike operative për arsim para universitar dhe shëndetësi primare, grantet për kompetencat e shtuara, të hyrat vetanake të komunave, transferet për kompetencat e deleguara, grantet e jashtëzakonshme, ndihma financiare nga jashtë. Ndërsa, aspekti i huamarrjes së komunave do të jetë si opsjoni i mundshëm i financimit që është paraparë në ligjin përkatës dhe në kuadër të rregullës fiskale të përcaktuar në LMFPP të dakorduar me Misionin e FMN-së.

Të gjitha të hyrat nga burimet në vijim janë të hyra vetanake të Komunës: tatimi në pronë, taksat komunale, gjobat, tarifat dhe pagesat në pajtim me autoritetin që u është dhënë komunave me LFPL.


Komunat pranojnë Grante Operative nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe ato janë: Granti i Përgjithshëm, Granti Specifik për Arsim dhe Granti Specifik për Shëndetësi, përfshirë financimin për shëndetësi sekondare. Grantet bazohen në kriteret e drejta, transparente dhe objektive, duke ju dhënë kështu komunave pavarësi më të madhe në alokimin dhe shpenzimin e tyre.

Sipas Qarkores së parë nr.2023/01, të dt. 13.05.2022 të lëshuar nga ana e MF-ve për periudhën 2023 - 2025 për Komunën e Gjakovës është caktuar për financimin e shpenzimeve 3 vjeçare si në tabelën 2.

Tabela nr.2. Totali i Burimeve te financimit komunal për vitet: 2023 - 2025


Kategoritë BUXHETORE - Burimet e financimit	2022	2023	2024	2025
	Aktual	Vlerësuar	Vlerësuar	Vlerësuar
1 Granti i Përgjithshëm	9,989,347.00	13,219,265.00	14,181,223.00	15,122,235.00
2 Granti specifik i Arsimit	10,437,015.00	10,391,073.00	11,088,840.00	11,131,022.00
3 Granti specific i Shëndetësisë	3,283,258.00	3,467,988.00	3,641,387.00	3,823,457.00
Financimi për shërbimet rezidenciale		160,000.00	175,000.00	175,000.00
4 Të hyrat vetanake komunale	3,991,001.00	4,203,787.00	4,361,287.00	4,534,565.00
5 Financimi për teatro	116,310.00	116,310.00	116,310.00	116,310.00
TOTALI:	27,816,931.00	31,558,423.00	33,564,047.00	34,902,589.00

Grafiku i trendit të buxhetit komunal 2023-2025



Burimi: Qarkorja Buxhetore 2023/01, MF 2022

Grafiku i buxhetit komunal sipas burimeve të financimit 2023 - 2025



Burimi: Qarkorja Buxhetore 2023/01, MF 2022

Granti i përgjithshëm

Komunat do të pranojnë Grantin e përgjithshëm, i cili është grant i sistemit të mbyllur dhe do ta shfrytëzojnë për ushtrimin e kompetencave të caktuara komunale në përputhje me kuadrin ligjor.

Granti i Përgjithshëm mundëson një shkallë të arsyeshme të qëndrueshmërisë në të hyrat komunale, gjithashtu është mjet adekuat për vendosjen e barazive ndërmjet komunave dhe mundëson alokimin adekuat të burimeve për komunitet pakicë në komunat përkatëse.

Shuma e Grantit të përgjithshëm është dhjetë për qind (10%) e të hyrave totale buxhetore të Qeverisë qendrore, duke përjashtuar të hyrat nga shitja e aseteve, të hyrat tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara vetanake dhe të hyrat nga huamarrja.

Me qëllim të nivelimit të kapacitetit të ulët të hyrave vetanake të komunave më të vogla, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse (paushalle) prej 140,000.00 €, minus 1 € për kokë banori ose 0 € për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë.

Indikatorët që janë përdorur për alokimin e grandit të përgjithshëm në komuna janë:

- ❖ Numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë për qind (89%); përmasat gjeografike të Komunës me gjashtë për qind (6%); numri i popullsisë pakicë në komunë (3%); komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat kombëtare me dy për qind (2%).

- ❖ Të punësuarit në administratën e Drejtorive Komunale për Arsim para universitar, për Shëndetësi primare si dhe financimi i shërbimeve sociale si kompetencë e transferuar nga MPMS financohen nga Granti i përgjithshëm në komuna.

Sipas Qarkores së parë buxhetore nr.2023/01 për Komuna, të lëshuar nga ana e MF, me datë 14 Maj 2022, Granti i përgjithshëm për Komunën e Gjakovës, për vitin 2023 është paraparë në shumë prej 23,825,930.00 €.

Granti specifik për Arsim parauniversitar 2023

Granti Specifik për Arsim para universitar sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit para universitar të MASHTI për vitin 2023.

Grantin specifik për arsim para universitar për vitin 2023 është aprovuar në shumë prej 201.5 milion euro, nga të cilat 195 milion euro grant bazë dhe 6.5 milion euro politika në vazhdimësi dhe politika të reja si në vijim:

Paga dhe shtesa në shumë prej 181.3 milion euro;
Mallra dhe shërbime në shumë prej 17.8 milion euro;
Shpenzime kapitale në shumë prej 2.4 milion euro.

Formula trajton nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm, duke marrë për bazë këto kriterë:

- Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2020/2022;
- Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3 (bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 22/2013 të MASHTI-it);
- Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;
- Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollar 1:12;
- Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë 1:17.2, dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;
- Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2;
- Kalkulimi për stafin mësimdhënës të gjuhës angleze për klasën I dhe II;
- Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës 1 staf në arsimin parafillor dhe fillor;
- Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës 1 staf në arsimin e mesëm
- Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës 1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollë (roje);
- Kalkulimi i pagave dhe shtesave është bazuar në pagën mesatare aktuale në arsim parauniversitar;
- Shërbimi profesional Pedagogjik/Psikologjik;
- Koordinatorët e cilësisë;
- Kalkulimi i pagave për zëvendësimet gjate pushimeve të lehonisë 6%;
- Mallrat dhe shërbimet janë kalkuluar sipas kriterit për nxënës (23 euro për nxënës shumicë dhe 25 euro për nxënës pakicë) dhe për shkollë (1,500 euro për shkollë parafillore dhe fillore dhe 3,250 euro për shkollë të mesme);
- Kapitalet janë kalkuluar sipas kriterit 7 euro për nxënës;
- Kalkulimi i tri pagave pas pensionimit me kosto prej 1.5 milion euro;
- Paga për asistent për fëmijë me nevoja të veçanta me kosto prej 0.78 milion euro;
- Praktika profesionale me kosto prej 3.5 milion euro;
- Pagat jubilare sipas kontratës kolektive për Arsim, me kosto prej 1.25 milion euro;
- Paga për para fillor për shkolla (2 deri në 5 vjeç), me kosto prej 1.9 milion euro;

- v) Mallra dhe Shërbime për fëmijë (4 deri në 5 vjeç), me kosto prej 78,848 euro;
- w) Kosto e pagesës së procedurave për validim dhe akreditim për shkollat e mesme të larta profesionale (8 Shkolla), me kosto prej 38,400 euro.

Politikat e reja dhe ne vazhdimësi te aprovuara nga Komisioni i Granteve në vitin 2023 janë si vijon:

- a) 100 asistent për fëmijë me nevoja të veçanta dhe kategoria paga dhe shtesa për asistent për fëmijë me nevoja të veçanta me kosto prej 0.78 milion euro;
 - b) Mësimdhënësit me gjendje të rëndë shëndetësore, me kosto prej 1.7 milion euro,
 - c) Shpenzimet për shujta ditore për nxënësit nga klasa 1-5 me kosto prej 4 milion euro.
- Sipas MASHTI-të është raportuar numri për 11,083 nxënës më pak në arsim para universitar krahasuar me vitin paraprak. Duke u bazuar në zvogëlimin e vazhdueshëm të numrit të nxënësve nga viti në vit duke marrë për bazë parametrat mësimdhënës/nxënës sipas gjendjes aktuale, MASHT rekordon komunat se me rastin e pensionimit të stafit mësimdhënës mos të shpallin konkurs për pranimin e kuadrit të ri, por të sistemojnë mësimdhënësit të cilët nuk kanë normë ose nuk kanë normë të plotë.

Sipas Qarkores së parë buxhetore nr.2023/01, për Komuna, të lëshuar nga ana e MEF-it, me datë 13 Maj 2022, për Arsimin para universitar të Komunës së Gjakovës, për vitin 2023 është paraparë Granti në shumë prej 10,391,073.00 €.

Granti specifik për Shëndetësi primare

Granti specifik për Shëndetësi bazohet në sistem të hapur në përputhje me LFPL.

Grantin specifik për shëndetësi primare për vitin 2023 është aprovuar në shumë prej 62.6 milion euro.

Sipas Qarkores së parë buxhetore nr. 2023/01 të lëshuar nga ana e MEF-it, me datë 13 Maj 2022, për Shëndetësinë primare të Komunës së Gjakovës, për vitin 2023 është paraparë Granti në shumë prej 3,467,988.00 €.

Financimi për Teatro

Financimi për teatro për vitin 2023 është aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 903,235.00 euro.

Në total janë të parapara 116,310.00 € prej të cilave 73,810.00 € të destinuara për paga dhe 42,500.00 € për subvencione.

Parashikimi i të hyrave vetanake komunale 2023 - 2025

Projekcionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2023 bazuar, në vlerësimet makrofiskale, janë aprovuar në shumë prej 87.4 milion euro. Këto të hyra i shtohen financimit komunal krahas granteve komunale.

Projekcionet e të hyrave vetanake për secilën komunë janë bazuar në rekomandimet e komisionit të granteve, të përfshirë në raportin e Vlerësimit të Përshtatshmërisë së Financimit të Komunave.

Në këtë projekcion janë marrë parasysh të hyrat nga tatimi në pronat e paluajtshme sipas faturimit të tatimit në pronë (ngarkesat tatimore në pronë dhe tokë) dhe mesatarja e tri viteve të fundit e të hyrave jo tatimore, duke përjashtuar të hyrat nga gjobat e gjykatave dhe gjobat në trafik të hyra këto të cilat planifikohen nga niveli qendror.

Me Qarkoren buxhetore nr. 2023/01, për komunën e Gjakovës, për vitet: 2023 - 2025 është përcaktuar Planin i të hyrave vetanake si vijon:

- ❖ Viti 2023 4,203,787.00 €,
- ❖ Viti 2024 4,361,287.00 €,
- ❖ Viti 2025 4,534,565.00 €.

Komuna e Gjakovës ka propozuar që të hyrat vetanake të jenë për vitet 2023 - 2025 si në tabelën nr.3.

Kodet	BURIMI I TË ARDHURAVE	2023 Planifikim	2024 Planifikimi	2025 Planifikim
1	Administrata e përgjithshme	120,000.00	126,218.00	132,903.00
50013	Certifikatat e lindjes	77,647.00	81,670.00	85,996.00
50014	Certifikatat e kurorëzimit	16,471.00	17,324.00	18,242.00
50015	Certifikatat e vdekjes	4,314.00	4,538.00	4,778.00
50016	Certifikatat e tjera	5,960.00	6,269.00	6,601.00
50017	Taksa të verifikimit të dokumenteve të ndryshme	15,608.00	16,417.00	17,286.00
	Taksa administrative te ndryshme	-	-	-
	Prokurimi -Të hyrat nga Shpallja e tendereve			-
2	Drejtoria e Inspeksionit	50,000.00	52,591.00	55,377.00
50505	Inspektimi veterinar brenda vendit			
50507	Leje për plotësimin e kushteve sanitare teknike	33,700.00	35,446.00	37,324.00
50104	Gjobat nga inspektoriati	16,300.00	17,145.00	18,053.00
50019	Taksa administrative pijeve alkoolike			
3	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	2,893,682.00	2,983,295.00	3,083,589.00
50408	Qiraja për lokalet e komunës	50,000.00	51,873.00	51,873.00
40110	Tatimi mbi pronën dhe tokë	2,703,682.00	2,786,177.00	2,880,700.00
50001	Taksa për regjistrimin e automjeteve	140,000.00	145,245.00	151,016.00
4	Drejtoria e Shërbimeve Publike	40,000.00	42,073.00	44,301.00
50103	Sekuestrimi i automjeteve	1,463.00	1,539.00	1,620.00
50008	Të hyrat nga parkingjet	19,268.00	20,266.00	21,340.00
50005	Taksa për leje vozitje - autobusëve	3,659.00	3,849.00	4,052.00
50406	Të hyrat nga tregjet	15,610.00	16,419.00	17,289.00
50401	Shitja e makinave	-	-	
5	Drejtoria e Agrikulturës	30,105.00	31,665.00	33,342.00
50012	Shndërrimi I tokës bujqësore ne jo - bujqësore	28,625.00	30,108.00	31,703.00
	Shitja e drunjëve te konfiskuar	1,480.00	1,557.00	1,639.00
6	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik	100,000.00	105,181.00	110,752.00
50204	Leje - Taksa mbi firmën e biznesit	85,882.00	90,332.00	95,116.00
50221	Leje - Taksa për zgjatjen e orarit te punës	14,118.00	14,849.00	15,636.00
7	Kadastra	140,000.00	147,254.00	155,054.00
50504	Të hyrat nga shërbimet kadastrale	140,000.00	147,254.00	155,054.00
50503	Të hyrat nga Ekspertiza	-		

8	Drejtoria e Urbanizmit	500,000.00	525,908.00	553,763.00
50009	Lejet e ndërtimit - (Taksa administrative dhe Tarifa rregullative për rritjen e densitetit)	369,997.00	389,169.00	409,781.00
50011	Taksat komunale: Pëlqimet e ndryshme, ndarjet fizike, ekstraktet nga planet, lejet dhe pëlqimet për objektet e infrastrukturës dhe taksa nga leja mjedisore)	35,571.00	37,414.00	39,396.00
50405	Kompensimi për shfrytëzimin e hapësirës publike: (Kompensimi për objektet montuese- de montuese, për panot reklamuese dhe për hapësirat publike)	38,112.00	40,087.00	42,210.00
50408	Qiraja: (Qiraja për shfrytëzimin e banesave nga programi i banimit social)	13,974.00	14,698.00	15,477.00
	Propozim - Taksat komunale nga trajtimi i ndërtimeve pa Leje – legalizimi i objekteve	42,346.00	44,540.00	46,899.00
9	DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT	10,000.00	10,520.00	11,075.00
	Të hyrat nga kultura, rinia dhe sportet	10,000.00	10,520.00	11,075.00
	Dënimet në trafik-direkt nga MF-i			
	Te hyrat nga Gjykata			
	Të hyrat nga Pyjet			
I.	TOTALI I ADMINISTRATES KOMUNALE	3,883,787.00	4,024,705.00	4,180,156.00
II.	ARSIMI	250,000.00	262,954.00	276,882.00
III.	SHENDETËSIA	70,000.00	73,628.00	77,527.00
	SUB TOTALI I + II + III	4,203,787.00	4,361,287.00	4,534,565.00
IV.	Participimet e qytetarëve dhe të hyrat tjera etj.			
	SUB TOTALI I + II + III+IV+V	4,203,787.00	4,361,287.00	4,534,565.00

Tabela nr.3 – Vlerësimet preliminare për të hyrat vetanake të Komunës së Gjakovës 2023 - 2025.

Parashikimi i shpenzimeve buxhetore për periudhën 2023 - 2025

Për të pasur një pasqyrë mbi shpenzimet buxhetore të Komunës së Gjakovës sipas kategorive ekonomike buxhetore, në tabelën vijuese të këtij KAB-i, po paraqesim trendët historike të shpenzimeve për periudhën e dy viteve të kaluara: 2020, 2021, dhe buxhetin aktual 2022, me ç'rast mund të shihen shumat e mjeteve të shpenzuara buxhetore sipas destinimeve dhe pozicioneve buxhetore.

Tabela 4. Trendet historike të financimit sipas strukturës ekonomike për Komunën e Gjakovës 2020-2022.

	Komuna e Gjakovës	2020 (Shpenzuar)	2021 (Shpenzuar)	2022 (Aktual)
1	Paga dhe mëditje	14,242,132.73	15,812,416.02	14,430,000.00
2	Mallra dhe shërbime	3,687,338.49	3,258,299.35	3,564,341.00
3	Shpenzime komunale	532,669.54	561,203.48	578,700.00
4	Subvencione dhe transfere	682,270.70	591,453.67	600,500.00
5	Shpenzime kapitale	8,195,519.73	7,235,856.79	8,643,390.00
Totali :		27,339,931.19	27,459,229.31	27,816,931.00
	Numri i stafit	2252	2252	2252

Propozimi i financimit të Komunës së Gjakovës sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve për periudhën: 2023 - 2025 është si në tabelën 5.

Tabela 5. Kufijtë e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike të vlerësuara për Financim për komunën e Gjakovës: 2023 - 2025

	Komuna e Gjakovës	2023 Vlerësuar	2024 Vlerësuar	2025 Vlerësuar
1	Paga dhe mëditje	15,200,000.00	15,602,087.00	15,679,169.00
2	Mallra dhe shërbime	3,700,000.00	3,779,315.00	3,807,981.00
3	Shpenzime komunale	628,700.00	657,243.00	680,689.00
4	Subvencione dhe transfere	620,500.00	731,763.00	780,665.00
5	Shpenzime kapitale	11,409,223.00	12,793,639.00	13,954,085.00
Totali :		31,558,423.00	33,564,047.00	34,902,589.00
	Numri i stafit	2252	2252	2252

SQARIM - Shpërndarja e Buxhetit komunal për periudhën: 2023 - 2025, siç shihet edhe në tabelën e lartshënuar, sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve, është bërë konform limiteve buxhetore të përcaktuara me Qarkoren e parë buxhetore 2023/01, të dt.13.05.2022 të lëshuar nga ana e MF-ja.

STRUKTURA E BUXHETIT PËR VITIN 2023

Struktura e Buxhetit Komunal sipas vlerësimeve të para për vitin 2023 duket si vijon:

Paga dhe mëditje	15,200,000.00	48.16%
Mallra dhe shërbime	3,700,000.00	11.72%
Shpenzime komunale	628,700.00	1.99%
Subvencione	620,500.00	1.97%
Investime kapitale	11,409,223.00	36.15%
TOTALI	31,558,423.00	100.00%

Stuktura e buxhetit për vitin 2023




Tabela 6. Kufijtë buxhetor sipas drejtorive për vitin 2023

Kodi	Programet	Nr. Pun	Paga dhe Meditje	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione dhe Transfer	Shpenzime Kapitale	TOTAL
160/16016	Zyra e Kryetarit	15	140,210.00	80,000.00		20,000.00		240,210.00
163/16316	Aministrata dhe Perso	59	337,850.00	400,000.00	65,000.00		200,000.00	1,002,850.00
166/16631	Inspektimet	23	166,450.00	100,000.00				266,450.00
167/16780	Prokurimi	6	43,000.00	10,000.00				53,000.00
169/16916	Zyra e Kuvendit Komunal		170,000.00	20,000.00				190,000.00
175/17516	Buxhet dhe Financa	31	185,000.00	75,000.00			902,223.00	1,162,223.00
180/18016	Shërbimet Publike -	13	90,000.00	800,000.00	150,000.00	30,000.00	4,800,000.00	5,870,000.00
180/18420	Zjarrfikësat dhe Insp	55	370,000.00	80,000.00	20,000.00		250,000.00	720,000.00
195/19580	Zyra Komunale për K	5	36,000.00	22,000.00		30,000.00		88,000.00
470/47016	Bujqësi, Pylltari dhe	18	90,000.00	22,000.00	2,000.00	110,000.00	400,000.00	624,000.00
480/48016	Zhvillimi Ekonomik	12	80,000.00	45,000.00		110,000.00	370,000.00	605,000.00
650/65080	Shërbimet Kadastrale	19	110,000.00	40,000.00	10,000.00		1,500,000.00	1,660,000.00
660/66385	Planifikimi Urban dh	18	120,000.00	81,841.00				201,841.00
730	Shëndetësia dhe Mirë	359	2,982,746.00	381,000.00	61,000.00	70,000.00	530,000.00	4,024,746.00
73025	Administrata	6	50,000.00	21,000.00				71,000.00
73950	Shërbimet e Shëndet	353	2,932,746.00	360,000.00	61,000.00	70,000.00	530,000.00	3,953,746.00
755/75576	Shërbimet Sociale	18	120,000.00	35,000.00	8,200.00	5,000.00	150,000.00	318,200.00
	Shërbimet Rezidenciale						160,000.00	160,000.00
850	Kultura, Rinia dhe Spo	48	329,000.00	137,950.00	65,000.00	185,500.00	1,446,000.00	2,163,450.00
85016	Shërbimet Kulturore	25	190,000.00	100,000.00	55,000.00	133,000.00	1,436,000.00	1,914,000.00
85056	Përkrahja e rinisë	1	9,000.00	10,000.00		10,000.00	10,000.00	39,000.00
85175	Teatri	22	130,000.00	27,950.00	10,000.00	42,500.00		210,450.00
920	Arsimi dhe Shkenca	1553	9,829,744.00	1,370,209.00	247,500.00	60,000.00	701,000.00	12,208,453.00
92080	Administrata	12	80,000.00	695,000.00	25,100.00	60,000.00	525,500.00	1,385,600.00
92510	Arsimi parashkollor	90	540,000.00	126,600.00	27,000.00		85,000.00	778,600.00
93450	Arsimi fillor	1121	7,100,000.00	270,600.00	106,600.00		35,000.00	7,512,200.00
94650	Arsimi i mesëm	330	2,109,744.00	278,009.00	88,800.00		55,500.00	2,532,053.00
	TOTAL KËRKESAT	2252	15,200,000.00	3,700,000.00	628,700.00	620,500.00	11,409,223.00	31,558,423.00

Tabela 6. Kufijtë buxhetor sipas drejtorive për vitin 2024

Kodi	Programet	Nr. Pun.	2024 Paga dhe shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione dhe Transfer	Shpenzime Kapitale	TOTAL
160/16016	Zyra e Kryetarit	15	140,210.00	80,000.00		20,000.00		240,210.00
163/16316	Aministrata dhe Perso	59	337,850.00	400,000.00	65,000.00		-	802,850.00
166/16631	Inspektimet	23	166,450.00	110,000.00				276,450.00
167/16780	Prokurimi	6	43,000.00	10,000.00				53,000.00
169/16916	Zyra e Kuvendit Komunal		170,000.00	20,000.00				190,000.00
175/17516	Buxhet dhe Financa	31	185,000.00	80,000.00			3,083,639.00	3,348,639.00
180/18016	Shërbimet Publike - Inf	13	90,000.00	770,000.00	163,443.00	30,000.00	5,215,000.00	6,268,443.00
180/18420	Zjarrfikësat dhe Inspek	55	370,000.00	90,000.00	18,000.00		50,000.00	528,000.00
195/19580	Zyra Komunale për Kor	5	36,000.00	24,000.00		40,000.00		100,000.00
470/47016	Bujqësi, Pylltari dhe Zh	18	90,000.00	23,000.00	3,000.00	150,000.00	400,000.00	666,000.00
480/48016	Zhvillimi Ekonomik	12	80,000.00	45,000.00		117,263.00	200,000.00	442,263.00
650/65080	Shërbimet Kadastrale	19	110,000.00	54,500.00	10,000.00		1,500,000.00	1,674,500.00
660/66385	Planifikimi Urban dhe	18	120,000.00	101,206.00				221,206.00
730	Shëndetësia dhe Mirëc	359	2,982,746.00	412,000.00	62,000.00	110,000.00	290,000.00	3,856,746.00
73025	Administrata	6	50,000.00	22,000.00				72,000.00
73950	Shërbimet e Shëndetës	353	2,932,746.00	390,000.00	62,000.00	110,000.00	290,000.00	3,784,746.00
755/75576	Shërbimet Sociale	18	120,000.00	38,000.00	8,400.00	12,000.00	100,000.00	278,400.00
	Shërbimet Rezidenciale						175,000.00	175,000.00
850	Kultura, Rinia dhe Spor	48	329,000.00	147,000.00	65,000.00	192,500.00	1,300,000.00	2,033,500.00
85016	Shërbimet Kulturore	25	190,000.00	109,050.00	55,000.00	140,000.00	1,290,000.00	1,784,050.00
85056	Përkrahja e rinisë	1	9,000.00	10,000.00		10,000.00	10,000.00	39,000.00
85175	Teatri	22	130,000.00	27,950.00	10,000.00	42,500.00		210,450.00
920	Arsimi dhe Shkenca	1553	10,231,831.00	1,374,609.00	262,400.00	60,000.00	480,000.00	12,408,840.00
92080	Administrata	12	80,000.00	695,000.00	40,000.00	60,000.00	445,000.00	1,320,000.00
92510	Arsimi parashkollar	90	642,087.00	131,000.00	27,000.00		35,000.00	835,087.00
93450	Arsimi fillor	1121	7,300,000.00	270,600.00	106,600.00			7,677,200.00
94650	Arsimi i mesëm	330	2,209,744.00	278,009.00	88,800.00			2,576,553.00
TOTAL		2252	15,602,087.00	3,779,315.00	657,243.00	731,763.00	12,793,639.00	33,564,047.00

Tabela 6. Kufijtë buxhetor sipas drejtorive për vitin 2025

Kodi	Programet	Nr. Pun.	2025 Paga dhe shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione dhe Transfer	Shpenzime Kapitale	TOTAL
160/16016	Zyra e Kryetarit	15	140,210.00	80,000.00		26,665.00		246,875.00
163/16316	Aministrata dhe Perso	59	337,850.00	400,000.00	65,000.00			802,850.00
166/16631	Inspektimet	23	166,450.00	120,000.00				286,450.00
167/16780	Prokurimi	6	43,000.00	10,000.00				53,000.00
169/16916	Zyra e Kuvendit Komunal		170,000.00	20,000.00				190,000.00
175/17516	Buxhet dhe Financa	31	185,000.00	80,000.00			4,344,374.00	4,609,374.00
180/18016	Shërbimet Publike - Inf	13	90,000.00	778,000.00	185,689.00	30,000.00	6,127,000.00	7,210,689.00
180/18420	Zjarrfikësat dhe Inspek	55	370,000.00	90,000.00	18,000.00		200,000.00	678,000.00
195/19580	Zyra Komunale për Kor	5	36,000.00	24,000.00		40,000.00		100,000.00
470/47016	Bujqësi, Pylltari dhe Zh	18	90,000.00	24,000.00	3,000.00	170,000.00	450,000.00	737,000.00
480/48016	Zhvillimi Ekonomik	12	80,000.00	45,000.00		125,000.00	150,000.00	400,000.00
650/65080	Shërbimet Kadastrale	19	110,000.00	54,500.00	10,000.00		1,500,000.00	1,674,500.00
660/66385	Planifikimi Urban dhe	18	120,000.00	101,772.00				221,772.00
730	Shëndetësia dhe Mirëc	359	3,229,457.00	418,000.00	63,000.00	120,000.00	150,000.00	3,980,457.00
73025	Administrata	6	50,000.00	23,000.00				73,000.00
73950	Shërbimet e Shëndetës	353	3,179,457.00	395,000.00	63,000.00	120,000.00	150,000.00	3,907,457.00
755/75576	Shërbimet Sociale	18	120,000.00	39,000.00	8,600.00	14,000.00		181,600.00
	Shërbimet Rezidenciale						175,000.00	175,000.00
850	Kultura, Rinia dhe Spo	48	329,000.00	149,000.00	65,000.00	195,000.00	176,000.00	914,000.00
85016	Shërbimet Kulturore	25	190,000.00	111,000.00	55,000.00	142,500.00	166,000.00	664,500.00
85056	Përkrahja e rinisë	1	9,000.00	10,000.00		10,000.00	10,000.00	39,000.00
85175	Teatri	22	130,000.00	28,000.00	10,000.00	42,500.00		210,500.00
920	Arsimi dhe Shkenca	1553	10,308,913.00	1,374,709.00	262,400.00	60,000.00	435,000.00	12,441,022.00
92080	Administrata	12	80,000.00	695,000.00	40,000.00	60,000.00	435,000.00	1,310,000.00
92510	Arsimi parashkollar	90	719,169.00	131,100.00	27,000.00			877,269.00
93450	Arsimi fillor	1121	7,300,000.00	270,600.00	106,600.00			7,677,200.00
94650	Arsimi i mesëm	330	2,209,744.00	278,009.00	88,800.00			2,576,553.00
TOTAL		2252	15,925,880.00	3,807,981.00	680,689.00	780,665.00	13,707,374.00	34,902,589.00

Vlera e kufinjëve preliminare të buxhetit për programet buxhetore komunale është e harmonizuar me vlerën e propozuar nga drejtoretë për të hyrat komunale për vitet 2023 – 2025.

Zyra e Kryetarit

Deklarata e vizionit:

Një Komunë shembull për Komunat tjera me mundësi zhvillimi me të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët e saj dhe trajtimi i prioriteteve në të gjitha fushat e zhvillimit si Komunë.

Deklarata e misionit:

Krijimi i rregulloreve të reja në harmoni me ligjet e aplikueshme, zbatimi i të gjitha dispozitiveve ligjore dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me qeverisjen komunale, zhvillimin ekonomik, ngritjen e transparencës, llogaridhënieve, efikasitetit të shërbimeve dhe rritjen e mirëqenies së banorëve të Komunës së Gjakovës

Deklarata e Qëllimit:

Zhvillimin e përgjithshëm të Komunës së Gjakovës, hapja e vendeve të reja të punës, përmirësimi i klimës së biznesit përmes inovacionit dhe subvencionimit të ndërmarrësve të rinj, arritura e nivelit më të lartë të standardit të jetës së banorëve të Komunës sonë, ngritje e nivelit të përgjithshëm të arsimit, përmirësimi i shërbimeve shëndetësore, tejkalimi i problemeve për kushtet bazike të jetës dhe përbushja e ndryshimit të qëndrueshëm të Komunës së Gjakovës sonë. Përveq kësaj synojmë ta përvetësojmë nivelin e performances dhe lidhur me këtë të përfitojmë fonde shtesë nga donatorët.

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2023 - 2025

	ZYRA E KRYETARIT	2022 Aktual	2023 Vlerësuar	2024 Vlerësuar	2025 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	125,150.00	140,210.00	140,210.00	140,210.00
2.	Mallra dhe shërbime	80,000.00	80,000.00	80,000.00	80,000.00
3.	Subvencione	20,000.00	20,000.00	20,000.00	26,665.00
4.	Shpenzime Kapitale				
	TOTALI	225,150.00	240,210.00	240,210.00	246,875.00
	Numri i stafit	16	16	16	16

Informata mbi Udhëheqësinë:

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës,

Zyra e Kuvendit Komunal

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2023 - 2025

	ASAMBLEJA KOMUNALE (DELEGATËT)	2022 Aktual	2023 Vlerësuar	2024 Vlerësuar	2025 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	130,000.00	170,000.00	170,000.00	170,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	20,000.00	20,000.00	20,000.00	20,000.00
	TOTALI	150,000.00	190,000.00	190,000.00	190,000.00
	Numri i stafit				

Informata mbi Udhëheqësinë:

Arbënesha Kuqi

Kryesues i Kuvendit të Gjakovës,

Drejtoria e Administratës dhe Personelit

Deklarata e Vizonit:

Vizioni i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme është të rrisë efikasitetin e shërbimeve komunale, të shkurtojë kohën për kryerjen e shërbimeve, të digitalizojë shërbimet administrative të ofrojë transparencë në këto shërbime, të rrisë shërbimet informative komunale, instalimin e shtyllave multifunksionale duke ofruar qetësi dhe siguri për qytetarët e Komunës së Gjakovës. Njëkohësisht ti përmbushë obligimet e Drejtorisë që ka sipas statutit të Komunës dhe ligjt në fuqi, si dhe në menaxhimin e stafit të shërbimit civil. Krijimi dhe mishërimi i një kodit të etikës profesionale në kulturën institucionale në terma afatgjatë.

Deklarata e misionit:

Misioni i Drejtorisë për Punë të Përgjithshme administrative është të zbatojë të gjitha procedurat administrative të cilat janë me ligj, statut dhe rregulloren e punës së kuvendit, të ofrojë qasje transparente dhe shërbime efikase në të gjitha shërbimet administrative; të ofrojë konsultentë për bashkëpunim për të gjitha drejtoritë tjera dhe Kryetarin e Komunës, sigurimin e këshillave në zhvillimin organizativ dhe për formulimin, autorizimin dhe zbatimin e menaxhimit dhe programet zhvillimore të stafit, ofrimin e një shërbimi digital dhe të shpejtë për të gjithë qytetarët e Komunës së Gjakovës, përgjegjësit dhe detyrat të cilat rrjedhin për qështjet e integrimeve europian; Bashkëpunim me të gjitha Ministritë relevante për të ofruar qasje të drjetëpërdrejtë për të gjitha punët administrative, gjithashu dhe punë të tjera që kanë të bëjnë me qështjet administrative që vijnë nga Kuvendi, Kryetari dhe Drejtoritë tjera.

Deklarata e Qëllimit:

Qëllimi i Drejtorisë është që të ofrojë një pasqyrë transparente, rritje të efikasitetit të shërbimeve komunale dhe të rrisë mirëqenjën dhe efikasitetin e shërbyesve civil pranë administratës komunale. Përfitues të objektivave dhe vizionit të Drejtorisë janë qytetarët e Komunës së Gjakovës.

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2023 - 2025

	DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT	2022 Aktual	2023 Vlerësuar	2024 Vlerësuar	2025 Vlerësuar
1	Paga dhe mëditje	326,000.00	337,850.00	337,850.00	337,850.00
2	Mallra dhe shërbime	390,000.00	400,000.00	400,000.00	400,000.00
3	Komunalitë	65,000.00	65,000.00	65,000.00	65,000.00
4	Shpenzimet kapitale	320,000.00	200,000.00	-	0.00
	TOTALI	1,101,000.00	1,002,850.00	802,850.00	802,850.00
	Numri i stafit	58	58	58	58

Informata mbi Udhëheqësinë:

Kosovar Alija

Drejtor i Drejtorisë së Administratës dhe Personelit,

Zyra e Prokurimit

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2023 - 2025

	PROKURIMI	2022 Aktual	2023 Vlerësuar	2024 Vlerësuar	2025 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	39,000.00	43,000.00	43,000.00	43,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00
	TOTALI	49,000.00	53,000.00	53,000.00	53,000.00
	Numri i stafit	6	6	6	6

Informata mbi Udhëheqësinë:

Faton Gutaj

Udhëheqës i Prokurimit,

Drejtoria e Inspeksionit

Deklarata e Vizionit:

Vizioni i Drejtorisë për Punë Inspektuese për periudhën e shënuar, është që të hartoj dhe amendamentoj Rregullore Komunale nga fushë veprimtaria e saj, si Rregullore të Inspektimit për Inspektorët nga Drejtoria për Punë Inspektuese, hartimin e disa dokumenteve tjera mbështetëse, menaxhuese të punës, përshkruese të punës dhe dokumenteve tjera punuese. Këto dokumente do të përfshijnë: Manualin e Punës së Inspektimit, Instruksionet e Inspektimit për secilën fushë të inspektimit, duke përfshirë karakteristikat e fushëveprimit (veterinarinë, bujqësinë, mjedisin, sanitarinë, tregun etj.); Përshkrimeve të Punës sa më të sakta me natyrën e punës, kompetencat e duhura, aftësitë specifike, detyrat, raportimet etj. Gjithashtu Drejtoria për Punë Inspektuese, ka përvizion dhe detyrë që të zbatoj të gjitha procedurat, udhëzimet dhe politikat për implementimin sa më të mirë të aktivitetave të kësaj drejtorie, të cilat do të bëhen konform udhëzimeve strategjike të Kryetarit së Komunës, dhe njëkohësisht ti përbushë obligimet e Drejtorisë që ka sipas statutit të Komunës dhe Ligjeve në fuqi, si dhe të menaxhoj Inspektorët, buxhetin dhe financat e kësaj drejtorie.

Deklarata e Misionit:

Misioni i Drejtorisë për Punë Inspektuese është inspektimi i subjekteve ekonomike si dhe ndërmarrja e masave komforë ligjeve në fuqi, me qëllim të parandalimit të dukurive negative: mbrojtën e shëndetit publik, mbrojtjen e ambientit, mbikëqyrjen e zbatimit të Rregulloreve Komunale dhe ligjeve në fuqi, mbrojtjen e konsumatorit etj. Harmonizimi me ligjet në fuqi duke i definuar qartë përgjegjësitet komforë autorizimeve dhe obligimeve ligjore.

Deklarata e Qëllimit:

Qëllimi i Drejtorisë për Punë Inspektuese është të kontribuoj në arritjen e politikave strategjive dhe objektivave të urdhëresave përmes inspektimeve efektive dhe efikase në lëmitë përkatëse që i takojnë Drejtorisë për Punë Inspektuese. Të kontribuojë në ngritjen e kapaciteteve dhe rritjen e efikasitetit të shërbimeve Komunale dhe të kontribuoj në rritjen e mirëqenies së qytetarëve të Komunës së Gjakovës.

Tabela1. Performance: Kufijtë e Shpenzimeve: 2023 - 2025

	DREJTORIA PËR INSPEKSION	2022 Aktual	2023 Vlerësuar	2024 Vlerësuar	2025 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	146,000.00	166,450.00	166,450.00	166,450.00
2.	Mallra dhe shërbime	80,000.00	100,000.00	110,000.00	120,000.00
	TOTALI	226,000.00	266,450.00	276,450.00	286,450.00
	Numri i stafit	24	23	23	23

Informata mbi Udhëheqësinë:

Hysni Muhadri
Drejtor i Inspeksionit,

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Deklarata e vizonit:

Planifikimin e buxhetit komunal sipas Qarkoreve Buxhetore, menaxhimin e financave komunale, këshillimi i zyrtarëve komunal për procedurat dhe rregullat në lidhje me buxhetin dhe financat. Krijimit të një sistemi unik dhe transparent të pagesave dhe lidhur me këtë rritja e të hyrave vetanake.

Deklarata e misionit:

Bënë menaxhimin e buxhetit dhe financave të Komunës, i siguron informatat për drejtoritë – programet komunale, menaxhimin e shpenzimeve, llogarive të arkëtueshme dhe informimin e udhëheqësve komunal lidhur me gjendjen dhe aktualitetet e ndërlidhura me buxhetin komunal.

Deklarata e Qëllimit:

Menaxhimi me eficencë të buxhetit komunal, përgatitja e buxhetit komunal për të gjitha programet buxhetore brenda afateve kohore te përcaktuara nga MF, rishikimet buxhetore, rialokimet, transferet, bartja e të hyrave vetanake, regjistrimi i pasurive financiare dhe jo financiare në pronësi komunale, analizat, raportet financiare etj.

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve : 2023 - 2025

	DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA	2022 Aktual	2023 Vlerësuar	2024 Vlerësuar	2025 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	179,000.00	185,000.00	185,000.00	185,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	75,000.00	75,000.00	80,000.00	80,000.00
3.	Shpenzimet kapitale	783,000.00	902,223.00	3,083,639.00	4,344,374.00
	TOTALI	1,037,000.00	1,162,223.00	3,348,639.00	4,609,374.00
	Numri i stafit	31	31	31	31

Informata mbi Udhëheqësinë:

Durim Halilaj

Drejtore i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,

Drejtoria e Shërbimeve Publike

Deklarata e vizonit:

Drejtoria e Shërbimeve Publike do të jetë e njohur për ofrimin e shërbimeve publike sa i përket profesionalizmit. Vizion ynë i qartë është përmbyllja e infrastrukturës rrugore në tërë territorin e Komunës.

Deklarata e misionit:

Misioni i Drejtorisë për Shërbime Publike është për të ruajtur dhe zhvilluar në mënyrë efektive infrastrukturën dhe objektet publike dhe ofron shërbime për publikun për të arritur dëshirat e përbashkëta sociale, ekonomike dhe mjedisore. Drejtoria për Shërbime Publike merr një qasje proaktive drejtë qëndrueshmërisë duke shëndrruar metodat e transportit, konsumit të energjisë, menaxhim me mbeturina, planifikimin urban dhe arkitekturë të qëndrueshme për të ruajtur dhe për të përmirësuar qytetin për brezat e ardhshëm.

Deklarata e Qëllimit:

Për të mirëmbajtur, mbrojtur dhe për të ruajtur në kuadër të autoritetit të parashikuara në Ligjet e Kosovës si dhe Rregulloreve të Komunës, strukturat fizike dhe objektet të cilat janë përcaktuar të nevojshme për qëllime publike dhe për të ofruar shërbime për publikun për të lehtesuar arritjen e përbashkët sociale, ekonomike, dhe dëshirat mjedisore.

Tabela1. Performance: Kufijtë e Shpenzimeve : 2023 - 2025

	DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE	2022 Aktual	2023 Vlerësuar	2024 Vlerësuar	2025 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	81,700.00	90,000.00	90,000.00	90,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	750,000.00	800,000.00	770,000.00	778,000.00
3.	Komunalitë	150,000.00	150,000.00	163,443.00	185,689.00
4.	Subvencione	20,000.00	30,000.00	30,000.00	30,000.00
5.	Shpenzimet kapitale	4,430,390.00	4,800,000.00	5,215,000.00	6,127,000.00
	TOTALI	5,432,090.00	5,870,000.00	6,268,443.00	7,210,689.00
	Numri i stafit	13	13	13	13

Informata mbi Udhëheqësinë:

Shkumbin Kastrati

Drejtor i Drejtorisë për Shërbimet Publike,

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim + Zjarrfikëset

Deklarata e Vizionit:

Vizioni i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim është përmirësimi i ambientit dhe krijimi i kushteve përfunksionimin e institucioneve publike dhe private, për një jetë të qetë dhe të sigurt të qytetarëve, Ofrimi i sigurisë njerëzore, të kafshëve dhe bimëve, ofrimi i mjetave në përkrahje të dëmtuarve dhe përmirësimi i kualitetit të jetesës etj.

Deklarata e Misionit:

Ky mision ka përfshillim krijimin e bazës metodologjike dhe profesionale për ndërmarrjen e masave dhe veprimeve konkrete në parandalimin, zvogëlimin dhe sanimin e dëmeve të shkaktuara nga katastrofat dhe fatkeqësitë tjera të mëdha natyrore të cilat me efekt të menjëherëshëm do të shkaktonin dëme në popullatën civile, pronën e tyre, në mjedisin, trashëgiminë kulturore etj.

Deklarata e Qëllimit:

Bënë koordinimin sa më efikas të drejtorisë me subjekte relevante të gjitha niveleve të cilat janë përgjegjëse që të veprojnë shpejtë dhe në mënyrë profesionale në rastet e fatkeqësive natyrore dhe katastrofave tjera të mundshme, si dhe koordinimi i ekipeve emergjente me subjektet përkatëse në menaxhimin e situatave emergjente. Parandalimi dhe zvogëlimi i pasojave të mundshme nga fatkeqësitë e ndryshme në kohë dhe hapësirë.

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2023 - 2025

	DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM + ZJARRFIKËSAT	2022 Aktual	2023 Vlerësuar	2024 Vlerësuar	2025 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	360,000.00	370,000.00	370,000.00	370,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	75,000.00	80,000.00	90,000.00	90,000.00
3.	Komunalitë	18,000.00	20,000.00	18,000.00	18,000.00
4.	Shpenzime kapitale	-	250,000.00	50,000.00	200,000.00
	TOTALI	453,000.00	720,000.00	528,000.00	678,000.00
	Numri i stafit	55	55	55	55

Informata mbi Udhëheqësinë:

Haxhi Sejdiu

Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim,

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Deklarata e vizionit:

ZKKK mbron dhe promovon të drejtat e komuniteteve, krijon qasje të barabartë për të gjitha komunitetet në shërbimet publike, ngrit arsimimin tek komunitetet. Po ashtu, ZKKK bënë përpjekje në krijimin e kushteve për kthim të qëndrueshëm të refugjatëve, personave të zhvendosur dhe personave të riatdhesuar.

Deklarata e misionit:

Menaxhon dhe koordinon stafin e ZKKK-së si dhe punët dhe aktivitetet e saj me nivelin lokal, përkatësisht me Drejtoritë Komunale si dhe me nivelin qendor me Ministrinë për Kthim dhe Komunitete në projektin e kthimit të qëndrueshëm të personave të zhvendosur dhe të refugjatëve si dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme për ri-integrin e personave të riatdhesuar.

Deklarata e Qëllimit:

Qëllimi kryesor i ZKKK-së është promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre; zhvillimi dhe integrimi i të gjithë komuniteteve në Komunën e Gjakovës, krijimi i kushteve për kthim të qëndrueshëm të personave të zhvendosur, refugjatëve dhe të riatdhesuarve.

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2023 - 2025

	ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE	2022 Aktual	2023 Vlerësuar	2024 Vlerësuar	2025 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	29,000.00	36,000.00	36,000.00	36,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	20,000.00	22,000.00	24,000.00	24,000.00
4.	Subvencione	20,000.00	30,000.00	40,000.00	40,000.00
	TOTALI	69,000.00	88,000.00	100,000.00	100,000.00
	Numri i stafit	5	5	5	5

Informata mbi Udhëheqësinë:

Armend Behluli

Udhëheqës i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthime,

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim rural

Deklarata e vizonit:

Gjakova qendër e prodhimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore cilësore për Kosovën dhe rajonin.

Deklarata e misionit:

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë i harmonizuar sipas standardeve dhe praktikave të BE-së duke respektuar Politikat e Zhvillimit Rural (PZHR) të BE-së, normat ekologjike dhe konkurruese me vendet e rajonit dhe i mbështetur nga fondet zhvillimore lokale, qeveritare dhe ndërkombëtare.

Deklarata e Qëllimit:

Objektivat gjenerale të zhvillimit të bujqësisë së Komunës së Gjakovës janë në harmoni me objektivat dhe strategjinë zhvillimore 2014 – 2020 të Republikës së Kosovës dhe në koherencë me priorititetet e zhvillimit rural të rajonit dhe të BE-së:

Edukimi i vazhdueshëm / Përcjellja e inovacioneve në sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural;

Forcimi i zingjirit ushqimor, mbrojtja e kafshëve dhe menaxhimi i rrezikut në bujqësi;

Përfshirja sociale, zvogëlimi i varfërisë dhe zhvillimi ekonomik në viset rurale;

Mbështetja institucionale në riaktivizimin e fermave, plantacioneve bujqësore dhe kapaciteteve përpunuese ushqimore në Komunën e Gjakovës;

Përmirësimi i sistemit të ujitjes dhe rritje të sipërfaqeve punuese me sistem të ujitjes në funksion të rritjes së rendimentit;

Kultivimi i frutave të malit përmes ofrimit të qasjes në rrugët malore, me rregullimin e tyre.

Mbështetja e zhvillimit ekonomik të Komunës – subvencionimi me qëllim të nxitjes së investimeve në fushat:

- ❖ Pemëtari;
- ❖ Perimtari;
- ❖ Lavërtari;
- ❖ Blektori;
- ❖ Vreshtri;
- ❖ Bletari, dhe
- ❖ Produktet e veçanta (kërpudha, bimë medicinale dhe aromatike, kërmijtë, etj.).

Tabela1. Performancë: Kufijtë e Shpenzimeve: 2023 - 2025

	DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL	2022 Aktual	2023 Vlerësuar	2024 Vlerësuar	2025 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	90,000.00	90,000.00	90,000.00	90,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	20,000.00	22,000.00	23,000.00	24,000.00
3.	Komunalitë	1,000.00	2,000.00	3,000.00	3,000.00
4.	Subvencione	110,000.00	110,000.00	150,000.00	170,000.00
5.	Shpenzimet kapitale	290,000.00	400,000.00	400,000.00	450,000.00
	TOTALI	511,000.00	624,000.00	666,000.00	737,000.00
	Numri i stafit	17	17	17	17

Informata mbi Udhëheqësinë:

Gani Hajdari

Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

Deklarata e vizionit:

Komunë e zhvilluar ekonomikisht me shërbime cilësore dhe efikase për komunitetin, e integruar mirë në zhvillimin rajonal dhe ndërkombëtar.

Deklarata e misionit :

Krijimi i ambientit të përshtatshëm për zhvillim e ndërmarrjeve në sektorët më potencial zhvillimor, me theks të posaçëm në sektorët e prodhimit dhe përpunimit, turizmit, përfshirë artizanalet që promovojnë vlera të trashëgimisë kulturore, duke ofruar infrastrukturë të përshtatshme ligjore , ekonomike dhe sociale.

Deklarata e Qëllimit:

Promovimi i zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm në koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë me institucionet relevante sektoriale, bizneset, OJQ-të, shoqërinë civile, donatorët dhe investitorët potencial.

Objektivi i Përgjithshëm:

Të Zhvillohet dhe avancohet sektori i NMV-ve dhe turizmit në Gjakovë.

Objektivat Specifike: (OS)

1. Krijimi i kushteve për rritjen e numrit dhe të zgjerimit të kapaciteteve të NMV-ve prodhuuese;
2. Zhvillimi dhe promovimi i turizmit;
3. Sigurimi i klimës së favorshme për tërheqjen e investimeve të huaja dhe të diasporës;
4. Promovimi dhe rritja e bashkëpunimit ndërkufitar në fushën e biznesit dhe turizmit;
5. Zhvillimi dhe funksionalizimi i Gjakovës si Zonë e Lirë ekonomike;

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2023 - 2025

	DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK	2022 Aktual	2023 Vlerësuar	2024 Vlerësuar	2025 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	77,000.00	80,000.00	80,000.00	80,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	45,000.00	45,000.00	45,000.00	45,000.00
3.	Subvencionet	110,000.00	110,000.00	117,263.00	125,000.00
5.	Shpenzimet kapitale	170,000.00	370,000.00	200,000.00	150,000.00
	TOTALI	402,000.00	605,000.00	442,263.00	400,000.00
	Numri I stafit	12	12	12	12

Informata mbi Udhëheqësinë:

Ferdinand Kolaj

Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik,

Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi

Deklarata e Vizionit:

Proteksionizmi i punës së shërbimit kadastral, aplikimi i teknologjisë bashkëkohore komforë Ligjit mbi Kadastrën.

Deklarata e misionit:

Shqyrtimi i të gjitha kërkesave të aplikueshme dhe zgjidhja e tyre komforë dokumentacionit tekniko-gjeodezik, pronësor dhe ligjeve në fuqi.

Mision tjetër i dreitorisë është rilevimi i lagjeve dhe regjistrimi i pronave të pa luajtshme në tërë territorin e Komunës.

Deklarata e Qëllimit:

Përmes aplikimit të teknologjisë së përparuar të rritet efikasiteti dhe kualiteti i shërbimeve kadastrale, komforë saj edhe inkasimi i të hyrave nga kjo veprimtari si dhe shqyrtimi dhe zgjidhja e raporteve pasurore-juridike, komforë ligjeve ne fuqi.

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2023 - 2025

	SHËRBIMET KADASTRALE	2022 Aktual	2023 Vlerësuar	2024 Vlerësuar	2025 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	108,000.00	110,000.00	110,000.00	110,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	50,000.00	40,000.00	54,500.00	54,500.00
3.	Komunalitë	10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00
4.	Shpenzimet kapitale	1,000,000.00	1,500,000.00	1,500,000.00	1,500,000.00
	TOTALI	1,168,000.00	1,660,000.00	1,674,500.00	1,674,500.00
	Numri i stafit	19	19	19	19

Informata mbi Udhëheqësinë:

Gjevalin Nikollbibaj

Drejtor i Dreitorisë për Kadastër dhe Gjeodezi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Deklarata e vizionit:

Urbanizim gjithëpërfsirës për tërë territorin e Komunës si bazament për zhvillim të hovshëm të planifikuar në bazë të kornizës zyrtare ligjore përmes Planit Zhvillimor Komunal, Hartës Zonale Komunale dhe Planeve Rregullative të Hollësishme. Fuqizimi i shtrirjes dhe mbulimit të Komunës me Plane Urbanistike komforë legjislacionit aktual.

Deklarata e misionit:

Shqyrimi i të gjitha kërkesave të aplikuarve dhe zgjidhja e tyre komforë dokumentacionit tekniko-urbanistik dhe ligjeve në fuqi. Trajtimi dhe legalizimi i objekteve pa leje ndërtimi. Rekognisimi dhe krijimi i bazës me të dhëna për gjendjen urbane dhe biologjike të mjedisit. Përmbyllja e planifikimit hapësinor me dokumentacionet bazike si Plani Zhvillimor Komunal dhe Harta Zonale Komunale.

Deklarata e Qëllimit:

Përmes Kompletimit të platformës me dokumente hapësinore si Harta Zonale Komunale dhe Planet Rregulluese të mundësojmë zhvillimin e qëndrueshëm të Komunës, respektivisht të rrisim cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve, cilësinë e mjedisit dhe të hyrat buxhetore komunale. Të krijojmë platformë të saktë mbi gjendjen e mjedisit për iniciimin dhe implementimin e proceseve për sanim dhe rehabilitim të mjedisit si dhe aplikim të qasjeve inovative në fushën e planifikimit hapësinor.

Tabela1. Performance: Kufijtë e Shpenzimeve: 2023 - 2025

	DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT	2022 Aktual	2023 Vlerësuar	2024 Vlerësuar	2025 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	112,000.00	120,000.00	120,000.00	120,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	80,000.00	81,841.00	101,206.00	101,772.00
3.	Shpenzimet kapitale	-	-	-	0.00
	TOTALI	192,000.00	201,841.00	221,206.00	221,772.00
	Numri i stafit	18	18	18	18

Informata mbi Udhëheqësinë:

Arben Bakalli

Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm,

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Deklarata Vizionit:

Shëndet të mirë dhe mirëqenie sociale për popullatën e Komunës.

Deklarata e Misionit:

DSHMS bashkë rendit dhe mbikëqyr K.P.Sh. dhe QPS për :

- ❖ ofrimin e shërbimeve (specifike) në sasi, cilësi dhe llojshmëri për popullatën;
- ❖ avancimin e kushteve të punës së të punësuarve në këto sektorë;
- ❖ duke u bazuar në respektimin e normave ligjore;
- ❖ identifikon nevojat / kërkesat e qytetarëve dhe
- ❖ orienton shërbimet në KPSH dhe QPS në përmbytjen e kërkesave për ruajtjen e shëndetit dhe të mirëqenies sociale.

Deklarata e Qëllimit:

Plotësimi i nevojave dhe kërkesave të banorëve të Komunës për mirëqenie shëndetësore dhe sociale.

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2023 - 2025

	DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE	2022 Aktual	2023 Vlerësuar	2024 Vlerësuar	2025 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	2,724,764.00	2,982,746.00	2,982,746.00	2,982,746.00
2.	Mallra dhe shërbime	360,000.00	381,000.00	412,000.00	418,000.00
3.	Komunalitë	60,000.00	61,000.00	62,000.00	63,000.00
4.	Subvencione	70,000.00	70,000.00	110,000.00	120,000.00
5.	Shpenzimet kapitale	410,000.00	530,000.00	290,000.00	150,000.00
	TOTALI	3,624,764.00	4,024,746.00	3,856,746.00	3,733,746.00
	Numri i stafit	359	359	359	359

Shërbimet Sociale

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2023 - 2025

	DREJTORIA PËR SHERBIMET SOCIALE	2022 Aktual	2023 Vlerësuar	2024 Vlerësuar	2025 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	109,000.00	120,000.00	120,000.00	120,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	35,000.00	35,000.00	38,000.00	39,000.00
3.	Komunalitë	8,000.00	8,200.00	8,400.00	8,600.00
4.	Subvencionet	5,000.00	5,000.00	12,000.00	14,000.00
5.	Shpenzimet kapitale	-	150,000.00	100,000.00	0.00
	TOTALI	157,000.00	318,200.00	278,400.00	181,600.00
	Numri i stafit	18	18	18	18

Informata mbi Udhëheqësinë:

Adelina Shehu Kola

Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale,

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Deklarata e Vizonit:

Arritje e një kulture të avancuar dhe moderne, rini të shëndoshë, prosperuese në të gjitha lëmit, gjithëpërfshirëse dhe rezultate.

Deklarata e Misionit:

Përkushtimi permanent ndaj avancimit në lëmin e kulturës, rinisë dhe sporteve, ruajtjen e trashëgimisë dhe vlerave kulturore, teatrale, sipas kërkesave bashkëkohore që kanë të bëjnë me plotësimin e nevojave të komunitetit.

Deklarata e Qëllimit:

Arritja e standardeve sa më të larta në sferën e kulturës, rinisë dhe sporteve, vetëdijësim i përgjithshëm për ruajtje dhe prezantim të vlerave tradicionale.

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2023 - 2025

	DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT	2022 Aktual	2023 Vlerësuar	2024 Vlerësuar	2025 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	315,502.00	329,000.00	329,000.00	329,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	137,950.00	137,950.00	147,000.00	149,000.00
3.	Komunalitë	60,000.00	65,000.00	65,000.00	65,000.00
4.	Subvencione	185,500.00	185,500.00	192,500.00	195,500.00
5.	Shpenzimet kapitale	540,000.00	1,446,000.00	1,300,000.00	176,000.00
	TOTALI	1,238,952.00	2,163,450.00	2,033,500.00	914,000.00
	Numri i stafit	48	48	48	48

Informata mbi Udhëheqësinë:

Adea Roka

Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte,

Drejtoria për Arsim dhe Shkencë

Deklarata e vizonit:

Të sigurojë barazinë e mundësisë për të ndjekur arsimi cilësor për te gjithë nxënësit parashkollar, fillor dhe të mesëm të gjithë qytetarëve të Komunës përfshirë edhe pakicat / minoritetet, të mbështesë zhvillimin dhe aftësimin e personelit, të nxisë bashkëpunimin midis mësimdhënësve, prindërve, nxënësve dhe institucioneve arsimore.

DKA orienton të gjithë nën sektorët ne aktivitete e tyre të rregullta afatmesme, në planifikimin vjetor, të përkrahim, të bashkërendisim, të rregullojmë dhe të promovoja arsimin cilësor për te gjithë qytetarët.

DKA do të siguroj një bazë për bashkërenditjen dhe negocimin me agjensitë qeveritare me partnerët zhvillimor dhe me palët tjera kryesore ne sektorin e arsimit.

Deklarata e misionit:

Drejtoria për Arsim ushtron funksionet dhe përgjegjësit e saj ne bazë të ligjit për arsimin para universitar. Kjo drejtori krijon mundësinë për zhvillimin dhe përkrahjen e një sistemi gjithëpërfshirës arsimor ku siguron qasje të barabarte të gjithë fëmijëve për arsimin e tyre në institucionin parashkollar, arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë të Komunës. Gjithashtu krijon kushte dhe u jep mundësi të gjithë mësimdhënësve në aftësimin profesional përmirësimin e relevances, rritjen e kualifikimit. DKA kërkon forcimin e mekanizmave te llogaridhëniec përmes vlerësimit te performancës. Zbatimi i kurrikules nëpër shkolla, zbatimi i politikave te reja në arsim duke siguruar asistencë tek fëmijet me nevoja të veqanta, zhvillimi i praktikës profesionale, koordinatorët e cilësisë si dhe zbatimi i kontratës kolektive.

Deklarata e Qëllimit:

Arritja e standardeve të larta në sferën e arsimit, përfshirja e të gjithë fëmijëve në shkolla ku qëllimet janë ne harmoni me objektivat dhe Strategjinë zhvillimore ku përfshihen integrimet e institucioneve arsimore, zbatimin e programeve të veçanta për parandalimin e braktisjes se shkollës, identifikimi i fëmijëve me nevoja të veçanta si dhe transporti i nxënësve në shkolla.

Tabela1. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2023 - 2025

	DREJTORIA PËR ARSIM DHE SHKENCË	2022 Aktual	2023 Vlerësuar	2024 Vlerësuar	2025 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	9,477,884.00	9,829,744.00	10,231,831.00	10,308,913.00
2.	Mallra dhe shërbime	1,336,391.00	1,370,209.00	1,374,609.00	1,374,709.00
3.	Komunalitë	206,700.00	247,500.00	262,400.00	262,400.00
4.	Subvencione	60,000.00	60,000.00	60,000.00	60,000.00
5.	Shpenzimet kapitale	700,000.00	701,000.00	480,000.00	485,000.00
	TOTALI	11,780,975.00	12,208,453.00	12,408,840.00	12,441,022.00
	Numri i stafit	1553	1553	1553	1553

Informata mbi Udhëheqësinë:

Eranda Kumnova

Drejtor i Drejtorisë së Arsimit,

PROGRAMI KOMUNAL I INVESTIMEVE PUBLIKE (PIP)

Vlerësimi i Kapaciteteve Investuese

Është hulumtim i potencialit dhe burimeve të mundshme për financim të zbatimit të Planeve Zhvillimore, si dhe drejtimit te Investimeve Kapitale Publike.

Komunat në Republikën e Kosovës, kanë rol qendror në caktimin e prioriteteve te investimeve kapitale dhe në aranzhimin e investimeve lokale përmes mekanizmave të cilat i kanë në dispozicion. Kjo mund të përfshijë gjenerimin e të hyrave lokale, vjeljen e taksave dhe tarifave, zhvillimin e partneritetve publike-private, aranzhimin e ndarjes së drejtë të projekteve kapitale dhe borxheve.

Komunat po bëhen gjithnjë e më të vetëdijshme se investorët ndërkombetarë dhe të brendshëm, huadhënësit dhe agjencitë kreditore i konsiderojnë qeveritë lokale si klientë të mirë për biznes, me kusht që ato ti ndjekin praktikat e mira të afarizmit.

Kryetari i Komunës së bashku me Kuvendin Komunal si organ legjislativ dhe Komiteti për Politikë dhe Financa janë përgjegjëse për përgatitjen e buxhetit, i cili përfshinë programin e investimeve kapitale dhe buxhetin.

Draft Propozimi i Programit Komunal për Investime Publike në masë të duhur ka marrë parasysh kërkesat – propozimet fillestare të Drejtorive komunale (Programeve buxhetore) – Projektet e propozuara sipas prioriteteve të përcaktuara me Buxhetin për vitet 2023 / 2025 sipas proceseve buxhetore të zhvilluara gjatë këtij viti.

Sipas vlerësimeve të shpenzimeve totale buxhetore - investimet kapitale për vitin 2023 të mbeturë pas zbritjes se shpenzimeve te pagave, mallrave dhe shërbimeve, shpenzimeve komunale dhe subvencioneve te paraqitura, atëherë për investime kapitale për vitin 2023 mbetet shuma prej **11,409,223.00 €** nga buxhetit total i Komunës për vitin 2023.

Ndërsa për vitin 2024 mbetet shuma 12,793,639.00 € për shpenzimet kapitale dhe për vitin 2025 shuma prej 13,707,374.00 €, derisa Kërkesat e Drejtorive janë shumë më të mëdha se sa që ofrojnë limitet buxhetore sipas Qarkores së parë Buxhetore nr. 2023/01, të MF-së për Komunën e Gjakovës për periudhën: 2023 - 2025, siç shihet edhe ne Tabelën e Investimeve kapitale, e cila i bashkëngjitet këtij KAB-i.

Bashkangjitur:

Aneks 1. Lista e projekteve kapitale sipas Kërkesave të Drejtorive Komunale (Programeve Buxhetore);

Aneks 2. Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor për vitin 2023;

**Gjakovë,
Qershori 2022**

Drejtoria për Buxhet dhe Financa